



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



Adresa: Rr. 13 Dhjeton, Nr.1 Shkodër.

web: www.bashkiashkoder.gov.al

e-mail: keshilli@bashkiak@bashkiashkoder.gov.al

V E N D I M

Nr. 42, datë 30.6.2017

**Për dhënien e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme,
të shkaktuara nga zjarri**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.06.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 8, 9, 40, nenin 54 shkronja "dh", nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pika III/1/ shkronja "ë" të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore", udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", VKB nr.8, datë 30.1.2017 "Për buxhetin e bashkisë Shkodër për vitin 2017", me 26 vota pro,

V E N D O S I :

1. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z. Kin Voca**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 3 (tre) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **60,000** (gjashtëdhjetëmijë) lekë.
2. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z. Stak Arra**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **100,000** (njëqind mijë) lekë.
3. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z. Gurash Kola**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 3 (tre) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **60,000** (gjashtëdhjetëmijë) lekë.

4. Miratimin e dhënies së ndihmës së menjëhershme financiare familjes së **z. Pjerin Kola**, meqënëse ka pësuar dëme në banesë të shkaktuara nga zjarri. Familja e tij përbëhet prej 5 (pesë) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **100,000** (njëqind mijë) lekë.
5. Burimi i financimit do të jetë fondi rezervë i bashkisë i parashikuar në buxhetin e bashkisë për vitin 2017 të miratuar me VKB nr. 8, datë 30.1.2017.
6. Institucioni i Bashkisë Shkodër në programin buxhetor 10910 "Emergjencat Civile" ti shtohet kundërvlefta në lekë e fondit prej 320,000 (treqind e njëzet mijë) lekë shpenzime korente –artikulli 606 "Transferta tek individë", për tu përdorur si shpërblim për rastet e fatkeqësisë.
7. Ngarkohet administrata e bashkisë Shkodër të bëjë likuidimin e shumës 320,000 lekë.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.6.2017

Shpallur në datën 30.6.2017

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI





REPUBLIKË E SHQIPËRISE
 PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

7.10931 dt. 14.7.2017.

Nr.771/1Prot

Shkodër, më 12.07.2017

Lënda: Lidhur me vendimin nr.42, datë 30.06.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale përcaktuar në dispozitat e Ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin", ligjit nr.139/2015 "Për veçqeverisje vendore", nenit 25, nenit 34, gjërma c 40, 54/dt, 55/3 ligjit nr.8756,dt. 26.03.2001 "Për emergjencat civile", i ndryshuar, ligjit nr.130/2016 "Për buxhetin e vitit 2017" ligjit nr.950 dt. 26.06.2008 "Për menadhimin e sistemit buxhetor", i ndryshuar, VKM nr.329 dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmes ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" kreu III pika 1, gjërma "ë", Udhëzimit të Perbasimit të MPB dhe MF Nr.233 dt.24.06.2016 "Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", analizoi vendimin nr.42, datë 30.06.2017 të Këshillit Bashkiak Shkodër "Për dhënie ndihme financiare me burime financiare nga fondi rezervë i buxhetit të vitit 2017, fami levet:

- z.Kin Ybca në vlerën 60.000 lekë për fatkeqësi (zjarr) bashkia Shkodër-cyete (procesverbal konstatimi dt. 24.05.2017 i komisionit tekniko-administrativ),
- z.Stak Arra në vlerën prej 100.000 lekë, për fatkeqësi (zjarr) NJAD Rrethina bashkia Shkodër (procesverbal konstatimi dt. 24.05.2017 i komisionit tekniko-administrativ),
- z. Gurash Kola, në vlerën prej 60.000 lekë për fatkeqësi (zjarr) NJAD Veipçje fshati Llazë (sipas procesverbal konstatimi dt. 07.06.2017 i komisionit tekniko-administrativ),
- z. Pjerin Kola, në vlerën prej 100.000 lekë, për fatkeqësi (zjarr) NJAD Veipçje fshati Llazë (sipas procesverbal konstatimi dt. 07.06.2017 i komisionit tekniko-administrativ),

Pas shqyrtimit, Prefekti ja autorizon të procedoni pasi është në të drejtën e ju të dëmtuarit të përfitojë ndihmën e menjëhershme nga NJQV sipas VKM nr.329, dt.16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënjes së ndihmes ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore" kreu III, pika 1 gjërma "ë", por rekomandohet që procesi i konstatimit të gjencjes të jetë në kohën e duhur dhe sa më shpejt ndodhjes së ngjarjes¹ duke mos pasur si kriter catent e kërkuesës së tyre, pasi tashmë funksioni PMNZSH është funksion i NJQV, ndërkohë në kohën e miratimit të VKM nr.329/2012 situata e transferimit të disa funksioneve shtesë të pushteti vendor nuk ishte e tillë.

Me respekt,

PREFEKTI



Për efekt të fotografitimit Shkruar në...